

Përhëndetjel! Ky mesazh tregon pikat e ndryshme të kontaktit për fëmijët e sëmurë në Basel-Stadt dhe Baselland. Nëpërmjet 4 pyetjeve ju tregoj se në cilën pikë fëmija juaj merr ndihmën e duhur.

A është fëmija juaj i sëmurë dhe ju nuk jeni të sigurt nëse fëmija duhet të shkojë te mjekja ose mjeku?

Në këtë rast mund të mbështesim këshilltarët/këshilltarët e qendrës së këshillimit për prindër. Ata kanë formim mjekësor dhe bashkë me ju shohin se ku mund të marrë mbështetjen më të mirë fëmija juaj. Këshilltarët/këshilltarët mund të ndihmojnë edhe për çështjet mbi zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Numrat e telefonit dhe adresat e qendrës së këshillimit për prindër i gjeni në www.meinkindistkrank.ch.

A dëshironi të shkoni me fëmijën tuaj te një meke apo mjek?

Atëherë shkoni në këto pediatri. Për mbështetje në klinikë ju duhet një takim. Atë mund ta bëni në telefon. Në telefon mund të pyesni gjithashtu nëse fëmija duhet të shkojë në klinikë. Nëse nuk keni një mjek/e pediatër mund t'ju ndihmojë qendra e këshillimit për prindër.

A jeni të pasigurt nëse fëmija juaj duhet të shkojë në qendrën e urgjencës dhe mjeku/mjekja pediatër nuk është i arritshëm?

Atëherë mund të telefononi në qendrën e thirrjes së emergjencës mjekësore. Ajo ju këshillon falas në telefon dhe është e arritshme gjithmonë, edhe gjatë natës dhe në fundjavë 24 orë. Numri është 061 261 15 15.

A ka fëmija juaj një problem mjekësor, i cili nuk mund të presë?

Atëherë, shkoni në qendrën e urgjencës të Spitalit Pediatriak të Universitetit UKBB. Telefononi pediatri nëse problemi nuk është aq i rëndë.

Fëmija juaj është në një situatë kërcënuese për jetën?

Atëherë, telefononi direkt ambulancën në numrin 144.

Të gjitha adresat dhe informacionet i gjeni në www.meinkindistkrank.ch

Ju uroj të gjitha të mirat juve dhe fëmijës suaj!